

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe

VEPRIMI KUNDËR KRIMIT EKONOMIK NË SHQIPËRI (AEC - ALBANIA)

AKTIVITETI 4.2.4

"TRAJNIM PËR HETIMIN, NDEKJEN PENALE DHE GJYKIMIN E VEPRAVE PENALE TË FINANCIMIT TË TERRORIZMIT"

VENDI: HOTEL PREMIUM, DURRËS, SHQIPËRI; 16-17 MAJ 2019

KONTEKSTI I PROGRAMIT

Instrumenti Horizontal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (në vijim referuar si "Instrumenti Horizontal") bazohet në prioritetet e politikave të këtyre dy organizatave në kuadrin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë dhe në ekspertizën e KiE-s për përcaktimin e standardeve, monitorimin dhe metodologjitë e bashkëpunimit. Ai synon të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve kryesore të organeve përkatëse të monitorimit dhe këshillimit të Këshillit të Evropës në fushat e përcaktuara në Deklaratën e Qëllimit të nënshkruar më 1 prill 2014 nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës dhe Komisioneri i Bashkimit Evropian për Zgjerimin dhe Politikën e Fqinjësisë Evropiane.

Në fushën e luftës kundër krimit ekonomik, janë hartuar tre veprime specifike sipas shteteve në kuadër të Programit të Instrumentit Horizontal dhe më specifikisht: për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Këto veprime synojnë të përmirësojnë zbatimin e rekomandimeve kryesore të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO) dhe të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL), si dhe të forcojnë më tej kapacitetet institucionale në lidhje me prioritetet e reformave kombëtare të çdo shteti, si dhe me reformat e tjera të nevojshme në nivelin e politikave që dalin nga procesi i marrëveshjes për zgjerim.

Objektivat specifike të programit (OS) në Shqipëri (AEC-Albania):

- OS 1: Rishikimi i legjislacionit për financimin e partive politike dhe kuadrin institucional
- OS 2: Përmirësimi i sistemit të deklarimit të pasurive
- OS 3: Rishikimi i kuadrit legjislativ dhe strategjik për pastrimin e parave/luftën kundër financimit të terrorizmit
- OS 4: Rritja e kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit, ndjekjes penale dhe gjyqësorit për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit
- OS 5: Harmonizimi dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitutional

Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri zbatohet nga Divizioni i Krimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit - DG I me buxhet të përcaktuar prej 1 000 000 € për një periudhë prej 36 muajsh.

OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT

Trajnimi për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e financimit të terrorizmit është një veprimtari e organizuar nga AEC-Albania në kuadrin e Objektivit Specifik 4. Ky trajnim ka për qëllim të rrisë kapacitetet e drejtësisë penale për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e financimit të veprave penale të terrorizmit. Më specifikisht, ky trajnim ka për qëllim:

- Rritjen e kapaciteteve për zhvillimin e hetimeve financiare paralele dhe sistematike për çdo rast të lidhur me terrorizmin për zbulimin e të gjithë aktorëve të rrjetit dhe për përdorimin e teknikave speciale të hetimit si burime të rëndësishme të provave në rastet e financimit të terrorizmit.

- Adresimin e sfidave në rastet e financimit të terrorizmit që lidhen me disponueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave dhe prezantimin e praktikave më të mira evropiane në këto aspekte;
- Rritjen e ndërgjegjësimit për përdorimin e masave të tjera në fushën e drejtësisë penale, atë rregullatore dhe masa të tjera për goditjen e aktiviteteve të financimit të terrorizmit në rastet kur nuk është praktike që të sigurohet dënimi i financimit të terrorizmit, përdorimin e sanksioneve financiare të synuara për ngrirjen e fondeve të terroristëve dhe organizatave terroriste të shpallura, si dhe përdorimin e ligjit Anti-Mafia.

PJESËMARRËSIT

Në trajnim do të marrin pjesë pjesëmarrës nga sa më poshtë: Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, Drejtoritë Rajonale të Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroritë e Rretheve, Prokuroria dhe Gjykata e Krimeve të Rënda, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, dhe ekspertë të Këshillit të Evropës.

Për më shumë informacion, kontaktoni :

Znj. Liljana KACI
Oficere e Lartë Projekti
Njësia I – Divizioni i Krimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit - DG
I
Instrumenti Horizontal Kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri
Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë

Email: liljana.kaci@coe.int
Tel: +355 (0) 4 45 40 219
ëëë.coe.int/HF-AEC

VEPRIMI KUNDËR KRIMIT EKONOMIK NË SHQIPËRI (AEC-ALBANIA)
AKTIVITETI 4.2.4

**"TRAJNIM PËR HETIMIN, NDJEKJEN PENALE DHE GJYKIMIN E VEPRAVE PENALE TË
 FINANCIMIT TË TERRORIZMIT"**

AGJENDA

E ENJTE, 16 MAJ 2019	
9:30-10:00	Fjala e hapjes: - Zyra e Këshillit të Evropës - Gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda/Shkolla e Magjistraturës
10:00-10:30	Tipologjitë e financimit të terrorizmit: të dhënat financiare - Ekspert i Këshillit të Evropës Moderatore: Këshilli i Evropës
10:30-11:00	Risqet e financimit të terrorizmit dhe iniciativat kundër financimit të terrorizmit në Evropë dhe në rajonin mesdhetar - Eksperte e Këshillit të Evropës Moderatore: Këshilli i Evropës
11:00-11:15	Pushim për kafe
11:15-13:00	Zhvillimi i hetimeve të suksesshme financiare - hetimi financiar paralel dhe përdorimi i teknikave të posaçme të hetimit: sfidat dhe praktikatat e mira për diskutim - Ekspertë të Këshillit të Evropës Moderatorë: Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës
13:00- 13:30	Drekë
13:30-16:00	Disponueshmëria dhe pranueshmëria e provave: sfidat dhe praktikatat e mira për diskutim - Ekspertë të Këshillit të Evropës Moderatorë: Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës
16:00- 16:30	Përmbledhje dhe komente nga trajnerët

E PREMTE, 17 MAJ 2019

9:00 - 09:30	Prezantimi i legjislacionit italian për luftën kundër terrorizimit dhe Drejtorisë Kombëtare Italiane kundër Mafias dhe Terrorizimit (DNAAA) - Eksperte e Këshillit të Evropës Moderatore: Këshilli i Evropës
9:30 - 10:00	Legjislacioni francez dhe praktika në goditjen e financimit të terrorizmit - Ekspert i Këshillit të Evropës Moderatorë: Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës
10:00 - 11:30	Sigurimi i padive dhe ndërprerjes së financimit të terrorizmit: sfidat e identifikuar dhe praktikat e mira për diskutim - Ekspertë të Këshillit të Evropës dhe Shkollës së Magjistraturës Moderatore: Këshilli i Evropës
11:30 - 11:45	Pushim për kafe
11:45 - 12:30	Përmbledhje dhe diskutim i i rasteve të padive të suksesshme italiane - Eksperte e Këshillit të Evropës Moderatorë: Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës
12:30 - 13:00	Mësimet e nxjerra <i>tour de table</i> (pjesëmarrësit) Moderatorë: Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës
13:00 – 13:30	Përfundimet (ekspertët dhe moderatorët)
13:00- 13:30	Shpërndarja e certifikatave të trajnimit
13:30 -14:30	Drekë